

Fatjon Bunga
Mat - Shqipni

PSE EDHE SOT JEMI TË NDARË

Rri i heshtur në mendime
shpesh herë pyes vetin
pse edhe sotë jemi të ndarë
kush na e shkriu amanetin

Pse nuk nihet fjala e të parit
pse kaq shume po tutet populli
pse frigohna shumë prej hasmit
a mos vallë vetë u hapim krahët

Shumë enigma kam ndër veti
nuk po diç fill me u dhanë
pse të ndarë na shqiptarët
pse vajton Shqipnia Nanë

I çuditut jam pa masë
shpesh her kthehem vite pasë
dhe në luftë kur jena kanë
veç bashkim kërkojshim tanë

Veç diçka o mirë me dijtë
se Shypnia s'duhet rënkoj
Çdo shqiptarë mbi këtë dhe
për bashkin të kontribojë

E dy fjalë dua me u thanë
me shumë brenga në këtë shpirtë
kurr mos u dorzoni vllaznit mij
pa e ba bashkë këtë Nanë Shqipni

Juve si staf organizativ ju dëshiroj suksese e paçi arritje gjithmone
poetve garues ju deshiron suksese e arritje ne lartësi për pendën e tyre